



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNII PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.49/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidates për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Zoja Lohaj Konjufca, kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendra Komunale e Numërimit (QKN), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2026, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZP.Anr.49/2026, e datës 11.06.2026, e parashtruar nga Zoja Lohaj Konjufca, kandidate për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendra Komunale e Numërimit (QKN), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Me datën 11.06.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidates për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga radhët e subjektit politik LDK, Zoja Lohaj Konjufca, me të cilën pretendon se ka pasur mos përfshirje të saktë të votave në rezultatet e KQZ-së. E njëjta është njoftuar përmes telefonit (Viber) nga znj.Mirjeta Kuqi Krasniqi, me nr. tel. +38344407737, se në vendvotimin ku ajo dhe bashkëshorti i saj Sazan Kuqi, pas publikimit nga KQZ se ka përfunduar 100% numërimi i votave të kandidatëve në atë pikë, mungon një nga dy votat që ata të dy i kanë dhënë për mua veç e veç, por me të njëjtën kuti. Qendra e votimit për të cilin paraqitet ankesa është SH.M.L Teknike “ Rifat Gjota”- Pejë; numri i qendresë së votimit është 1704, në kutinë e votimit 1704/08. Tutje, theksohet se ankesa është bërë në pajtimin e të dy këtyre qytetarëve të lartpërmendur, si dhe dëshmitarja Mirjeta Krasniqi Kuqi, ka paraqitur ankesë përmes email -it në KQZ. Ndërsa, vetë ankuesja rastin e ka paraqitur edhe në policinë rajonale në Ferizaj, si dhe pretendon se ka edhe dy qytetare të tjerë në Pejë të cilët janë ankuar se vota për të nuk është shfaq pas numërimit total në kutin e votimit po kanë ngurruar të lajmërohen më tutje. Si provë ka bashkangjitur emrat e dëshmitarëve Mirjeta Kuqi Krasniqi dhe Sazan Kuqi, se bashku me numër personal dhe numrat e telefonit të të njëjtëve.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 12.06.2026, ka deklaruar se pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj jep sqarimet/ përgjigjet si më poshtë:

Bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr. 16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura Standarde e Veprimit për Aktivitetet në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, e miratuar më datë 26.05.2026, nr. 01/989/2026, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV, KQZ, pas pranimit të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunës së Pejës, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim:

“Po ju shkruaj në raport me ankesën të cilën parashtruesja pretendon që iu është bërë parregullsi gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit në Komunën e Pejës, ku gjatë gjithë procesit nuk kemi pasur asnjë ankesë ose pakënaqësi nga asnjë person që ishte prezent në QKN. Gjithashtu duhet të ceket që numërimi në QKN ka përfunduar me date 10.06.2026 dhe është zhvilluar në mënyrë të rregullt dhe pa ndonjë problem.” (E bashkangjitur deklarata e ZEKKZ),

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese e cila mbështetet në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave, dhe të afërmeve të saj, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Për më tepër, ky pretendim nuk mund të vërtetohet, pasi vota është e fshehtë dhe, në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës, në fletëvotim nuk mund të identifikohet votuesi. Gjithashtu, pritjet subjektive të ankueses për të marrë më shumë vota nuk përbëjnë dëshmi për parregullsi apo mungesë votash.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

- **Ankesa është e pa bazuar.**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e parashtrueses së ankesës Zoja Lohaj Konjufca, janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara si në ankesë se ka mospërputhje të rezultateve të numrit të votave të publikuara me numrin real të votave të konfirmuara nga dëshmitarët, paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e saj, kjo pasi që paraqitësja e ankesës nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e saj se i mungojnë votat, ndërsa pretendime e theksuara në ankese tani për tani mbeten në nivel të deklaratimit nga se nuk janë argumentuar me fakte dhe në prova konkrete.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese që mbështeten në deklaratimin e disa personave – votuesve, të identifikuar me emër dhe mbiemër, numër personal dhe numër të telefonit të tyre, nuk është provë e besueshme dhe bindëse e cila do të vërtetonte shkeljen e pretenduar.

Po ashtu sipas vlerësimit të panelit bazuar në nenin 4 paragrafi 1.3 të Ligji Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet E Përgjithshme Në Republikën E Kosovës "...1.3. liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjës për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim...", liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara, gjer sa shpërfaqja e vullnetit të votuesve në parim cenon fshehtësinë të votës. Lidhur me deklaratat e votuesve dhe fshehtësisë së votimit, është krijuar tashmë praktika gjyqësore nga se Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj AA.nr.61/2025 të datës 24.03.2025 kishte konstatuar se: "deklaratat e votuesve të cilët pretendojnë se kanë votuar një kandidat të caktuar nuk mund të merren si prova të bazuara për faktin se nuk mund të vërtetohet në asnjë formë se votuesit përkatës të kenë votuar për subjektin e caktuar dhe kandidatin e caktuar për shkak se fletëvotimi nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit".

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesja e ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar dhe e pa argumentuar, pasi që parashtruesja e ankesës nuk ka bashkangjitur prova bindëse, apo ndonjë dëshmi, formularët e rezultateve të subjekteve politike dhe të kandidatëve, librin e votimit, deklaratat e KVV apo dokumente të tjera, me të cilën do të vërtetoheshin këto pretendime.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZP.Anr.49/2026, më datën 12.06.2026



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.